



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk. II..nr.1338/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Construction Management Aleance Design (CMA Design) me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson A.K avokat nga Prishtina kundër paditurit Komuna e Prishtinës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.E.K.nr.313/19 datës 31.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Construction Management Aleance Design (CMA Design) me seli në Prishtinë, ANULOHET Aktvendimi III.EK.nr.313/19 e datës 31.08.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar III.EK.nr.313/19 datës 31.08.2021, e ka shpallur veten Jo kompetente në pikpamje lëndore në këtë çështje juridike dhe lëndën e ka dërguar në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë si Departament me kompetenc lëndore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, me arsyetimin se pala paditëse njëjtë si dhe Gjykata deri në vitin 2021 ka vazhduar të ketë lëndë në trajtim dhe është vendosur në intepretimin se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike është kompetente për të vendosur në kontestet mes personave juridik. Eshtë evidente se po të bëhet intepretim i ngushtë i dispozitës neni 16 par.1.1 të Ligjit për Gjykatat e Kosovës, len të kuptohet se në rastin e personave juridik nuk është kompetenc ekskluzive e Departamentit per çështje ekonomike por as që parashihet në Departamentetet e tjera. Duke qenë se Ligji per Gjykatat është në procedurë të ndryshimit, kërkojm të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar, të caktohet Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike si gjykat me kompetenc për të vendosur në lidhje me objektin e kërkespadis.

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktvendimin e shkallës së parë brenda kufijve, dhe shkaqeve të treguara në ankesë, si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar III.EK.nr.313/19 datës 31.08.2021, e ka shpallur veten Jo kompetente në pikpamje lëndore në këtë çështje juridike dhe lëndën e ka dërguar në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë si Departament me kompetenc lëndore. Vendimin e vet Gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në nenin 19 të LPK-së dhe nenit 16 paragrafi 1 nenp.1 I Ligjit nr.06/L-054 për Gjykatat, me arsyetimin se e paditura nuk mund të jetë palë në procedurë sepse nuk e ka statusin e shoqërisë tregtare.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (f) e LPK-së,

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit përkritazi me ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar dhe gjendjen e fakteve, ka gjetur se të njëjtat janë të bazuara.

Kolegji si fakt vendimtar në këtë çështje juridike ka marrë për bazë ndryshimet ligjore që kanë rezultuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e shpallur ne gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës datë 10 shkurt 2022, i cili Ligj në dispozitën e nenit 13 paragrafi 2, ka përcaktuar çështjet që trajtohen në kompetenc të Departamentit për çështje ekonomike. Andaj duke marrë parasysh edhe objektin e kontestit në këtë çështje juridike, Dhoma e Shkallës së Dytë erdhi në përfundim se Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është kompetent të trajtoj këtë çështje juridike kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitës se nenit 209 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së,dhe nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II. nr.1338/2022 datë 12.09.2022

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Krenar Berisha